



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/33 ;
Datë: 03.11.2020 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.10.2020 nxjerrë:

V E N D I M

për hapjen e diskutimit publik për miratimin e Planit të Integritetit ;

1. **I. Me këtë vendim hapet diskutimi publik për miratimin e Planit të Integritetit /në tekstin e mëtejme Plani/.**
- II. Rregullorja nga pika I. e këtij vendimi vihen në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III. Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV. Ekspozimi i Planit do të bëhet në zyrën e personelit të objektit të Komunës së Junikut.
- V. Diskutimi publik i Rregullores zgjat 15 ditë (fillon më: 11.11.2020 dhe përfundon më: 24.11.2020).
- VI. Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Plani ekspozohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII. Diskutimi publik i Planit organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut.
- VIII. Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të kësaj Rregulloreje.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Zyra e Kryetarit të Komunës.

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtorja për Shërbime publike mbrojtje dhe shpëtim;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem Krasniqi

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://kk.rks-gov.net/junik>